



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Nr. 414/23
Data 28.08.23



Prishtinë, 18 gusht 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1752_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25 dhe Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 14, Nenin 15 dhe 17 par. 5 dhe 6 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse;
- Metodologjinë e ZRRE-së, Nr. 01/2020 për Llogaritjen e Çmimit Referent për Energjinë e Prodhuar nga BRE;
- Vendimin V_927_2018 të datës 29 mars 2018 për lëshimin e Autorizimet Preliminar të lëshuar nga ZRRE;
- Dispozitivin nën pikën III dhe IV të Vendimit V_1740_2023 të datës 15 maj 2023 të nxjerr nga ZRRE.
- Aplikacionin/Kërkesën për Pranim në kornizën e rregulluar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, në lokacionin "Wind Park – Zatriç 1, me kapacitet të instaluar prej 35 MW komuna e Rahovecit, të datës 25.11.2022 nr. prot. 1183/22 të shoqërisë "EV WIND PARK" SH.P.K. me adresë sheshi "Sadik Shala – Rahovec, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 18 gusht 2023 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "EV WIND PARK" SH.P.K., me Numër Unik Identifikues (NUI) 810734568 dhe **PRANOHET** në kornizën e rregulluar operatori gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, në lokacionin "Wind Park – Zatriç 1, me kapacitet të instaluar prej 35 MW, ngastrat kadastrale nr. 00530-1, nr.00166-0, 00003-1, ZK Zatriç dhe nr. 00016-0, nr. 00754-0, ZK Kaznik komuna e Rahovecit komuna e Rahovecit.
- II.** Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet e drejta për shitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga BRE tek Operatori i Tregut përmes Marrëveshjes për Blerje të Energjisë me çmim (referent) të përcaktuar nga ZRRE në baza vjetore.
- III.** Çmimi referent i përcaktuar në baza vjetore nuk mund ta kaloj çmimin e tarifës nxitëse më të ulët i cili aplikohet për Burimet e Ripërtitshme të Energjisë sipas Vendimit të ZRRE-së.
- IV.** Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë elektrike me Operatorin e Tregut (KOSTT) në kohëzgjatje 15 vjeçare, në pajtim me kushtet ligjore të përcaktuara me rregullën në fuqi në kohën e aplikimit.
- V.** Afati i vlefshmërisë prej dymbëdhjetë (12) muaj i përcaktuar sipas Vendimit për Autorizimin Preliminar V_927_2018 të datës 29 mars 2018, do të filloj të rrjedh nga data e lëshimit të këtij Vendimi, ku aplikuesi detyrohet që brenda kësaj periudhe të plotësoj dëshmitë e mbetura sipas Rregullës për Procedurën e Autorizimit të nxjerr nga ZRRE dhe me shkrim të kërkoj lëshimin e Autorizimit për ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Turbinat e Erës.

Arsyetim

- o ZRRE me datë 25.11.2022 nga shoqëria "EV WIND PARK" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për pranim në kornizën e rregulluar për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, në lokacionin "WindPark – Zatriç 1, me kapacitet të instaluar prej 35 MW komuna e Rahovecit.



- o Dëshmitë e bashkangjitura nga ana e aplikuesit janë: Vendimi për Autorizimin Preliminar, Aplikacioni për pranim në kornizën e rregulluar, Vendimin për Pëlqimin Mjedisor të lëshuar nga MMPH, Vendimin nga Kuvendi Komunal Rahovec për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pronave, Planin Zhvillimor të Komunës së Rahovecit 2022-2030, Raportin mbi Studimet e Erës, Pëlqimin nga Agjencia e Pyjeve, ekstraktet e pronave, kontratat për shfrytëzimin e tokave.
 - o Aplikuesi ka theksuar se për shkak të specifikave të prodhueseve të turbinave dhe duke u bazuar në të dhënat e Erës, kapaciteti i cili është lejuar me Pëlqim Mjedisor të lëshuar nga Ministra e Mjedisit të pranohet në kornizën e rregulluar.
 - o Aplikuesi për tu pajisur me Autorizim për ndërtim sipas pikës V. të këtij Vendimi, duhet të pajiset me Marrëveshjen për Kyçjes të lëshuar nga KOSTT dhe Lejen Ndërtimore për projektin në fjalë të lëshuar nga MMPHI, dhe të dorëzoj në ZRRE për tu pajisur me Autorizim për ndërtim.
 - o Projekti është i përfshirë edhe në Planin Zhvillimor 2023-2031 të Komunës së Rahovecit, dhe gjithashtu ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese nga Burimet e Ripërtitshme është në përputhshmëri me Strategjinë e Energjisë 2022-2031 të Republikës së Kosovës.
 - o ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës/aplikacionit për pranim në kornizën e rregulluar, dëshmime mbështetëse dhe analizimit të tyre, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- VI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Rahovecit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së


Bordi i Rregullatorit:


Ymer Kezullahu, kryesues


Lutfije Dervishi, anëtare


Geni Bucaj, anëtar


Artë Isufi, anëtare


Adnan Preniqi, anëtar